



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI

Nr. 673.prot

Gramsh, më 15 / 02 / 2022

V E N D I M

Nr. 13 Dt. 15 / 02 / 2022

Për

**Dhënien e titujve vendorë të nderit (Çerifikata mirënjohje)**

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17.12.2015" Për vetëqeverisjen vendore" neni 3 gërma ç, neni 8 pika 2, neni 9 gërma b si dhe neni 64 i tij; Ligjit nr.112 datë 04.04.2013" Për dekoratat ,titujt e nderit ,medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë ,VKM-së nr.861 datë 10.12.2014" Per miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë",

**V E N D O S A:**

1. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Kristaq Stefan Binjaku** me motivacionin "Për kontributin e dhënë me punën dhe krijimtarinë e tij të pasur artistike në organizimin me cilësi të shumë veprimtarive ndër vite, për gjallërimin e jetës kulturore të të gjithë grupmoshave të Gramshit".
2. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Napoleon Gjike Sava** me motivacionin "Për kontributin e dhënë me punën dhe krijimtarinë e tij të pasur artistike në Gramsh, si dhe për përfaqësimin dinjitoz që u bën vlerave kulturore dhe natyrore të zones tonë në konkurse kombëtare e ndërkombëtare të pikturës".
3. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Gëzim Kasem Llalla** me motivacionin "Si një ndër piktorët më të talentuar të Gramshit, i cili ka lartësuar emrin e zonës sonë me përfaqësimin dinjitoz në konkurse kombëtare e ndërkombëtare të pikturës".
4. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Ardian Zenel Mullai** me motivacionin "Për kontributin e dhënë ndër vite në ruajtjen e sigurisë publike si dhe për transmetimin e vlerave dhe ngjarjeve historike ndër breza".
5. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Xhafer Rustem Roshi** me motivacionin "Për kontributin e dhënë ndër vite në transmetimin e vlerave dhe ngjarjeve historike ndër breza".
6. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z.Musa Hasan Kumria** me motivacionin "Për kontributin e dhënë ndër vite në ruajtjen e sigurisë publike si dhe për transmetimin e vlerave dhe ngjarjeve historike ndër breza".

7. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **znj.Sabire Ibrahim Bardhoshi** me motivacionin “Për kontributin e dhënë ndër vite për zhvillimin e qytetit si dhe transmetimin e vlerave dhe ngjarjeve historike ndër breza”.
8. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **z. Luan Zylal Mema** me motivacionin “Për kontribute dhe merita të veçanta në ruajtjen e sigurisë publike si dhe promovimin e pasurive kulturore dhe natyrore të bashkisë Gramsh”.
9. Ti jepet Çertifikatë Mirënjohje **znj.Margarita Xhepa** me motivacionin “Artiste e madhe e artit tone, e dashur për të gjithë në shqipëri, Margarita Xhepa banon edhe në Gramsh në çdo shtëpi”
10. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtori i Kabinetit si dhe Drejtori i Arsimit, Kulturës dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi Xh.Bajrami  
Miratoi A.Shulli  
Dosja nr. \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_

**KRYETARI**  
**Klodian TACE**

